

# FENOMENI MIZOR I LUFTËRAVE ME QEN

**Luftërat mes qenve** janë një nga format më të tmerrshme të mizorisë së organizuar ndaj kafshëve, jo vetëm për **dhunën** që qentë përjetojnë gjatë përleshjeve, por edhe për **traumën** që pësojnë gjatë gjithë jetës së tyre. **Metodat e stërvitjes janë brutale** dhe luftimet i shkaktojnë vuajtje fizike dhe mendore **mikut më të mirë të njeriut.**

## **ORGANIZIMI I LUFTËRAVE ME QEN ËSHTË VEPËR PENALE**

Sipas **Nenit 346, paragrafi 4, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës**, kushdo që organizon, financoi ose është nikoqir i luftës ndërmjet kafshëve të llojeve të njejta apo të ndryshme ose organizon apo merr pjesë në bast në këto luftëra, **dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.**



Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve  
Animal Rights Foundation  
Fundacija za prava životinja



# SHENJAT E ABUZIMIT TË QENVE

- Plagë të hapura ose prerje në trupin e kafshës
- Kafsha ka mavijosje, gjakderdhje ose lëndime tjera të dukshme
- Trup jashtëzakonisht i hollë
- Çalim/pamundësi për të ecur
- Qen të lënë vazhdimisht vetëm (të lidhur me zinxhir) jashtë pa ushqim dhe ujë, apo në rastin e komuniteteve urbane, në hapësira të errëta të izoluar jashtë syrit të publikut
- Qentë mbahen jashtë edhe në mot ekstrem me pak ose pa strehë fare
- Qentë mbahen të lidhur me zinxhir të trashë rreth qafës - edhe gjatë ushtrimeve, për rritje të agresivitetit dhe forcës
- Shtëpi me sasi të tepërt të qenve (zakonisht të llojit Pitbull, Kangal, Terrier, Qen i Sharrit)

## SI TË RAPORTONI LUFTËRAT MES QENVE

Nëse vëreni shenja tek qentë që janë përdorur ose rriten për t'u përdorur për përlëshje me qen të tjerë, apo keni informata rreth organizimit të veprimtarive të tilla në komunitetin ku jetoni, **DUHET TË NJOFTONI MENJËHERË POLICINË NË NUMRIN 192** ose përmes email adresës **info@kosovopolice.com** apo fizikisht në stacionin më të afërt policor.

Po ashtu mund të drejtoheni edhe në Prokurori dhe të raportoni rastin me të gjitha provat e nevojshme (vendi i mbajtjes së luftës, foto/video nga lufta, emra të personave të përfshirë dhe prova të tjera relevante) ose përmes email adresës **info.psh@rks-psh.org**.

Nëse hasni në neglizhencë të Policisë në trajtimin e raportimeve të rasteve të luftërave me qen, duhet t'i drejtoheni Inspektoratit Policor të Kosovës në **https://ipk.rks-gov.net/**.

**!! Mosraportimi i një vepre penale përbën vepër penale në vetvete!**

